Kjo Apostile nuk do te perdoret ne Mbreterine e Bashkuar dhe konfirmon vetem vertetesine e nenshkrimin, vules ose stampes ne dokumentin publik bashkelidhur te MB. Nuk konfirmon vertetesine e dokumentit themelor. Apostilet e bashkangjitura dokumenteve qe jane fotokopjuar dhe certifikuar ne Mbreterine e Bashkuar konfirmojne nenshkrimin e zyrtarit te Mbreterise se Bashkuar i cili kreu vetem certifikimin. Ai nuk verteton as nenshkrimin ne dokumentin origjinal ose permbajtjen e dokumentit origjinal ne asnje menyre. Nese ky dokument do te perdoret ne nje vend qe nuk eshte pale ne Konventen e Hages te 5 tetorit 1961, ai duhet t'i paraqitet sektorit konsullor te misionit qe perfaqeson ate vend.

Per te verifikuar kete apostille shkoni ne www.verifyapostille.service.gov.uk



Tirane me 20.05.2021

Une i nenshkruari, Alexandre Nathanel Ephraim Boauziz, I biri I Philippe Bouaziz, lindur me 29 Prill 1993, mbajtes i pasaportes me nr: 14DR65362, ne cilesine e CEO (Drejtorit Ekzekutiv) te Shoqerise "DEEL, INC", e regjistruar ne shtetin e Delaware, Shtetet e Bashkuara te Amerikes autorizoj:

Znj. Sonila Shtar, qytetare Shqiptare, lindur ne Tirane, me leter njoftimin nr: 036471466, dhe **Znj. Xhilberta Selamaj**, qytetare Shqiptare, e lindur ne Kucove, me leter njoftim nr: 037008042;

duke qene pjese e studios ligjore Wolf Theiss shpk, qe sebashku ose vecmas te ndermarrin te gjitha veprimet e nevojshme, perfshire nenshkrimin e dokumentave te cilat mund te nevojiten ose kerkohen, per kryejen e aplikimit prane QKB-se, lidhur me regjistrimin e Shoqerise "DEEL ALBANIA" si dhe te dorezoje cdo dokument te nevojshem lidhur me kete aplikim

Administratori

(nenshkrimi)

Z. Alexandre Nathanel Ephraim Boauziz

DEEL INC

Vendim i shkruar i Bordit te Drejtoreve te DEEL INC

date 20 Maj 2021

Z. Alexandre Nathanel Ephraim Bouaziz;
Znj. Shuo Wang

Duke pasur autoritetin per te vendosur per ceshtjet e trajtuara ne vendim, dhe ne perputhje me aktet e themelimit te DEEL INC, me ane te ketij vendimi, pa kushte dhe ne menyre te pakthyeshme japin pelqimin per miratimin me shkrim te ceshtjeve te meposhtme dhe vendosin si me poshte:

- A. Te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne Republiken e Shqiperise (Shoqeria), te zoteruar teresisht nga DEEL INC. Shoqeria do te kete te dhenat e meposhtme themelore te shoqerise sipas Statutit te saj:

1. Emri i Shoqerise

Emri i Shoqerise eshte "DEEL Albania" shpk

2. Ortaku i Vetem

DEEL Inc, nje shoqeri Amerikane, e regjistruar me numrin unik te identifikimit tatimor nr. 61-1852855, dhe ka seline ne 1013 Center Road, Suite 403-B, ne Qytetin Wilmington, Qarku i New Castle, Shteti i Delaware, eshte themeluesi dhe ortaku i vetem i Shoqerise, ("Ortaku i vetem").

3. Selia

Selia ligjore e Shoqerise eshte WOLF THEISS Tirana, Qendra e Biznesit Eurocol, Rruga Murat Toptani, kati i 4, 1001, Tirane, Shqiperi.

4. Forma ligjore

Shoqeria eshte formuar si nje person juridik Shqiptar qe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin Shqiptar.

5. Kohezqatja e aktivitetit

Kohezgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar

6. Objekti i aktivitetit

6.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:

Ofrimi i shërbimeve të burimeve njerëzore dhe shërbimet e programeve të pagave nëpërmjet softwarit.

6.2 Për më tepër, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtëpërdrejt ose indirekt, si pasojë ose e lidhur me objektivat e renditura më sipër. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion të tillë si veprimtari tregtare, financiare, me qira ose hipoteke, të cilat mund të konsiderohen të dobishme ose të nevojshme për të ndjekur objektin e Shoqërisë.

7. Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i Shoqërisë është 1000 leke (një mijë leke), i përbërë nga një kuotë e cila përfaqëson 100% të kapitalit.

Kapitali fillestar do të jetë në pronësi të plotë të Ortakut të Vetëm, dhe i cili do të kontribuojë në të CASH.

8. Administrator

Administratori i parë i Shoqërisë, për një kohezgjatje prej 5 vjetësh do të jetë:

Z. Alexandre Nathanel Ephraim Bouaziz, një qytetar francez lindur më 29 Prill 1993, në Francë dhe banor në 126 Avenues Simon Bolivar 75019 Paris dhe mbajtës i pasaportës nr: 14DR65362

B. Të miratojë çdo dhe të gjitha kushtet dhe dispozitat e Aktit Themelues dhe të Statutit të Shoqërisë.

C. Të autorizojë administratorin e shoqërisë për të ndjekur procedurat e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në autoritetet e tjera përkatëse.

Bordi i Drejtoreve të Deel, Inc.

(nenshkrimi)

Z. Alexandre Nathanel Ephraim Boauziz
Znj. Shuo Wang

Mbeshtetur ne Nenin 28 paragrafi 3 te Ligjit Nr 9723/2007 per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:



AKTIN E

THEMELIMIT

DHE

STATUTIN

E

"DEEL ALBANIA" SHPK

KAPITULLI I

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Shoqeria "DEEL ALBANIA" (ne vijim "Shoqeria) e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi Sh.p.k, cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, eshte themeluar ne date _____ 2021.
- 1.2 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga
- (I) fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk"
 - (II) numn i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj
 - (III) adresa e regjistruar ,dhe
 - (iv) pasqyrim e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqerise

- 2.1 Shoqeria eshte nje entitet ligjor Shqiptar, dhe ka formen ligjore e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne perputhje me Ligjin nr 9901, date 14 04 2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji i shoqerive"), i ndryshuar.

Neni 3. Selia Shoqerise

- 3.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen "WOLF THEISS Tirana, Qendra e Biznesit Eurocol, Rruga Murat Toptani, kati i 4, 1001, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4. Kohezqjatja

4.1 Kohezqjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.



KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i aktivitetit

5.1 Ne momentin e miratimit te Statutit, objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte:

Ofrimi i sherbimeve te burimeve njerezore dhe sherbimet e programeve te pagave nepermjet softwarit.

Per me teper, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari qe lidhet drejtperdrejt ose indirekt, si pasoje ose e lidhur me objektivat e renditura me siper. Per te arritur qellimin e mesiper, Shoqeria mund te kryeje cdo transakcion te tille si veprimtari tregtare, financiare, me qira ose hipoteke, te cilat mund te konsiderohen te dobishme ose te nevojshme per te ndjekur objektin e Shoqerise.

Neni 6. Modifikimi

6.1 Shoqeria rezervon te drejten per te modifikuar objektin e saj te aktivitetit ne cdo kohe sic parashikohet nga ky Statut.

KAPITULLI III

Kapitali dhe Kuotat

Neni 7. Kapitali

7.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 1000 Leke i ndare ne 1 kuote e cila perfaqeson 100% te kapitalit.

Neni 8. Ortaket dhe Kuotat

- 8.1** Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, kapitali i Shoqerise eshte i zoteruar plotesisht nga Ortaku i Vetem:

DEEL Inc, nje shoqeri Amerikane, e regjistruar me numer unik te identifikimit te taksave nr. 611852855, dhe ka seline ne 1013 Center Road, Suite 403-B, ne Qytetin Wilmington, Qarku i New Castle, Shteti i Delaware.

Neni 9. Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1** Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendime te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.
- 9.2** Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para ose me ane te kontributeve ne natyre, si dhe me perfshirjen e rezervave (nese ka) ose fitimit apo kthimit te borxhit ne kapital.
- 9.3** Zmadhimi i kapitalit mund te behet duke emetuar kuota te reja apo duke rritur vleren nominale te kuotave ekzistuese.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

- 10.1** Te gjithe vendimet e ortakeve do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve. Vendimet e pa regjistruara ne regjister do te konsiderohen te pavlefshme. Ne nje Shoqeri me Ortak te Vetem, Ortaku i Vetem do te kete te gjithe te drejten e dhene nga Ligji i Shoqerise per Asamblene e Pergjithshme.
- 10.2** Cdo kuote i jep te drejten, ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), Ortakut qe e zoteron, te nje numri votash te barabarte me perqindjen e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise si dhe te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, kur deklarohet nga Ortaket e Shoqerise.
- 10.3** Ortaket do te kene akses te plote ne cdo informacion dhe te dhene qe ka lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, perfshire te drejten per te kontrolluar regjistrimet e Shoqerise dhe cdo dokument tjeter.

10.4 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri i ketyre Kuotave.

Neni 11. Transferimi i Kuotave

11.1 Kur nje Ortak propozon ne cdo kohe per te transferuar Kuotat ("**Transferuesi**") ose ndonje te drejte ose interes ne te, ai do te njoftoje administratoret me shkrim se propozon ta beje kete gje. Njoftimi i tille ("**Njoftimi i Transferimit**") do te permbaje numrin e kuotave qe do te shiten, ("**Kuotat perkatese**") me cmimin e specifikuar ne Njoftimin e Transferimit, ("**Cmimi i specifikuar**").

11.2 Brenda dhjete (10) diteve te punes pas marrjes se cdo Njoftimi Transferimi, administratoret do te bejne te mundur qe Ortaket e tjere ("**Ortaket e tjere**") te informohen me shkrim per numrin e kuotave perkatese dhe Cmimin e Specifikuar dhe te ftojne Ortaket e tjere te aplikojne me shkrim ne menyre te pakthyeshme tek Shoqeria brenda njezet (20) Diteve te Punes nga data e dergimit te nje njoftimit te tille per te blere disa ose te gjitha Kuotat perkatese me Cmimin e Specifikuar. Nese Ortaket e tjere aplikojne per te blere te gjitha Kuotat Perkatese, Transferuesi dhe Ortaket e Tjere jane te detyruar ta perfundojne kete shit-blerje ne seline e Shoqerise brenda dhjete (10) Diteve te Punes nga marrja e nje kerkese te tille nga Shoqeria. Nese Ortaket e Tjere aplikojne per te blere vetem disa nga Kuotat Perkatese, do te zbatohen dispozitat e Nenit 11.3.

11.3 Nese disa por jo te gjitha Kuotat Perkatese jane aplikuar ne perputhje me kushtet e Nenit 11.2, Shoqeria do te informoje menjehere Transferuesin i cili mund te terheqe Njoftimin e Transferimit brenda pese (5) diteve te ardhshme te punes. Transferuesi dhe Ortaket e Tjere jane te detyruar te perfundojne shitjen dhe blerjen e ketyre Kuotave Perkatese te kerkuara ne perputhje me Nenin 11.2 ne seline e Shoqerise brenda dhjete (10) diteve te ardhshme te punes pas perfundimit te pese (5) diteve te punes te permendura me lart.

11.4 Nese pas veprimit te Nenit 11.1 dhe Nenit 11.2, Ortaket e Tjere kane ose:

- (a) Nuk kane aplikuar per te blere ndonje nga Kuotat Perkatese; ose
- (b) Kane aplikuar per te blere disa por jo te gjitha Kuotat perkatese dhe Njoftimi i Transferimit eshte terhequr nga Transferuesi

Transferuesi do te jete i lire gjate nentehjete (90) diteve te ardhshme per te transferuar keto Kuota Perkatese qe nuk jane kerkuar nga Ortaket e Tjere te ndonje person tjetër (pervec nje konkurenti material te Shoqerise) ne nje shitje te mirefillte me cdo cmim te barabarte me ose me te madhe se Cmimi i Specifikuar.

KAPITULLI IV


Asambleja e Pergjithshme

Neni 12. Kompetencat

- 12.1** Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve është organi kontrollues dhe vendimmarres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 12.2** Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose me nje shumice prej $\frac{3}{4}$ e ortakeve pjesemarres ne mbledhje pasi te jete arritur kuorumi i kerkuar ne piken 86/1 te Ligjit per Shoqerite Tregtare ("Shumica e Kualifikuar") ne lidhje me ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- (i) aprovimin e strategjise se Shoqerise, Planit te Biznesit, planeve financiare dhe buxhetit;
 - (ii) aprovimin e cdo ndryshimi ne vijim ne Planin e Biznesit te Shoqerise dhe ne planet financiare.
 - (iii) shperndarjen e fitimeve;
 - (iv) pezullimin e aktivitetit te Shoqerise dhe/ose perfundimin, shperberjen apo likuidimin e Shoqerise;
 - (v) ndryshimet, amendimet apo zevendesimet ne aktin e themelimit dhe statutin e Shoqerise;
 - (vi) ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
 - (vii) prezantimin e cdo kerkese per likuidim apo falimentim;
 - (viii) krijimin e filialeve;

- (ix) struktura e brendshme dhe organizimin e Shoqerise;
- (x) bashkimin me Shoqeri te tjera, apo ndarjen dhe shkeputjen e Shoqerise;
- (xi) vleresimin e kontributeve ne natyre, ne mungese te eksperteve vleresues te emeruar, sipas Nenit 68/6 te Ligjit te Shoqerive;
- (xii) zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;

12.3 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te vendose me shumice te thjeshte votash prej 51% te Ortakeve prezent ne mbledhjen e asamblese, sapo kuorumi sipas nenit 86/1 te Ligjit te Shoqerive arrihet, ne lidhje me te gjitha ceshtjet e tjera te Shoqerise, si me poshte:

- 
- (i) Emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuidatoreve;
 - (ii) Percaktimi i shperblimit te auditoreve dhe likuidatoreve;
 - (iii) Monitorimin dhe mbikqyrjen e veprimtarise se Administratoreve ne zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise, pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - (iv) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - (v) Perfaqesimin e Shoqerise perpara Gjykates si dhe ne ceshtjet gjyqesore kunder Administratoreve; dhe
 - (vi) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - (vii) Ceshtje te tjera te cilat do te parashikohen nga Ortaket kohe pas kohe.

Neni 13. Thirrja

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mbledhet te pakten 1 here ne vit.


13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

- 13.4** Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje asetete qe i perkasin nje ortaku te Shoqerise, vlera e te cilave kalon 5% te aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 13.5** Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asambleja e Pergjithshme do te vendose ne baze te nje raporti nga nje ekspert kontabel i autorizuar, qe paraqitet tek kjo Asamble, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 13.6** Ortaket do te organizojne takime me Administratoret cdo tre muaj me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratoret gjate atij tre mujori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e Ortakeve, perfshire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord ne menyre unanime.
- 13.7** Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 14. Menyra e Thirrjes

- 14.1** Asambleja e Pergjithshme vendos per ceshtjet e paraqitura ne nenet 12 dhe 13 me siper, nepermjet thirrjes se mbledhjeve.
- 14.2** Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.
- 14.3** Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranes, Shqiperi ose ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me njoftim me shkrim ose poste elektronike te pakten 7 dite para mbledhjes. Persa i perket vendimeve qe merren jashte Republikes se Shqiperise, nje kopje e shkruar e ketyre vendimeve u vihet te dispozicion Administratorit(eve), te cilet duhet ta ruajne ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise, qe duhet mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratoreve. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjitha Ortaket bien dakort.
- 14.4** Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
- 14.5** Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Vendimi i propozuar se bashku me dokumentacionin



mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve nepermjet mjeteve te sigurta elektronike. Ortaku(et) do te marrin vendim per vendimin perkates brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar vendimi. Ortaku(et) miratojne vendimin duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te vendimit me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me vendimin shprehin me shkrim kundershite e tyre ne lidhje me vendimin dhe ia kthejne ate Administratorit(eve) te Shoqerise. Vendimi me shkrim konsiderohet i miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar ne perputhje me Seksionin 12, me siper.

- 14.6** Cdo kuote perfaqeson nje numer te caktuar votash, qe eshte i barabarte me perqindjen e kapitalit qe ka Ortaku qe zoteron kete kuote.
- 14.7** Vendimet e Ortakeve te marra ne perputhje me Ligjin per Shoqerite si dhe me kete statut do te jene te detyrueshme per Shoqerine. Cdo vendim i tille mund te merret gjithashtu jashte territorit te Republikes se Shqiperise, dhe nje evidence me shkrim e ketij vendimi do t'i dorezohet Administratorit(ve) qe do ta regjistrojne ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise.
- 14.8** Atehere kur ligji e kerkon kete, vendime te caktuara te Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto vendime miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).
- 14.9** Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.
- 14.10** Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 15. Perjashtimi nga e Drejta e Votes

- 15.1** Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:
- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku;
 - (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi te ketij Ortaku;
 - (iii) Ngritjen e nje padie nga Shoqeria ndaj ketij Ortaku;
 - (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja ketij Ortaku.

15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar me prokure nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KAPITULLI V
Administratori/et

Neni 16. Administratori/et

16.1 Shoqeria drejtohet nga nje Administrator. Administratori mund te jete i cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jete rezident ne Shqiperi.

16.2 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Administrator i Shoqerise eshte:

Z. Alexandre Nathanel Ephraim Bouaziz, shtetas Francez, lindur me 29 Prill 1993, ne France, dhe banues ne adresen 126 Avenue Bolivar 75019 Paris, mbajtes i pasaportes nr 14DR65362.

16.3 Kohezgjatja e emerimit te Administratorit eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti qe ky statut merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Regjistrimit), me te drejte rizgjedhjeje.

16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori/et njohin se marredhenia e tij/tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; ne kete drejtim vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Administratorin/et me shumice te thjeshte votash.

16.6 Per aq sa eshte e lejueshme nga dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratoreve kane fuqi vepruese, Administratoret kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht prezent ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimbursen Administratoreve shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Administratoreve ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratoreve.

Neni 17. Kompetencat dhe Detyrimet

17.1 Kompetencat e Administratorit/eve si perfaqesues i Shoqerise perfshijne per kete qellim kompetencat per:

(i)Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e parashikuara ne nenin 13;

(ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme;

(iii) Perfaqesimin e Shoqerise kur Administratoret unanimisht bien dakort qe eshte ne te mire te Shoqerise;

(iv) Te sigurohen per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;

(v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i propozohen Asamblese se Pergjithshme;

(vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme;

(vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e transakcioneve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;

(viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket, here pas here.

17.2 Administratori/et mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, punemarresit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe ne interesin me te mire te Shoqerise. Administratoret duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

Neni 18 The Fiduciary Duties and Liability

18.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, Administratori/et duhet:

(i) Te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, qe perfshin vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;

(ii) Te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

(iii) Te japin vemendjen e duhur ceshtjeve per te cilat merret vendim;

(iv) Te shmangin dhe parandalojne rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave te tyre personale me ato te Shoqerise;

(v) Te garantoje miratimin e dhene per marreveshjet e pershkruara ne paragrafin 3 te Nenit 13 te Ligjit te Shoqerive.

(vi) Te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

- 18.2** Administratoret mbajne pergjegjesi per cdo veprim apo mungese veprimi, me perjashtim te rasteve kur veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacionit te lidhur ne menyre te drejteperdrejte me qellimet e Shoqerise.
- 18.3** Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori duhet te demshperbleje Shoqerine, per cdo dem qe rrjedh nga kryerja e shkeljes. Ai gjithashtu duhet ti kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se shkeljeve te detyrave te tij. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Ne rast kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata jane pergjegjes ndaj Shoqerise ne menyre solidare dhe vecmas.
- 18.4** Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rezultojne, ne rast se kryen ne kundërshtim me Ligjin e Shoqerive veprimet e meposhtme:
- (i) Ju rishperndan kontributet Ortakeve;
 - (ii) Ju paguan interesa apo dividente Ortakeve;
 - (iii) Shperndan asetet e Shoqerise;
 - (iv) Lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi pagueese per te shlyer detyrimet e saj;
 - (v) Jep hua.

KAPITULLI VI

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 19.1** Ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga Legjislacioni Shqiptar.
- 19.2** Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me Legjislacionin shqiptar.

KAPITULLI VI

Aktiviteti I Shoqerise

Neni 20. Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e parë të muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-te të muajit Dhjetor të secilit vit.

Neni 21. Mbajtja e Llogarive

21.1 Shoqeria do të mbajë llogarite në Leke dhe në monedhe të huaj.

Neni 22. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

22.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet në baze të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Pergjithshme në perputhje me këtë Statut, dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2 Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezerve në perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezerve të detyrueshem.

22.3 Në baze të Ligjit për Shoqerite, Shoqeria mund të shperndajë fitimin tek Ortaket vetem nëse pas kësaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojnë teresisht detyrimet e kësaj të fundit, dhe
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve të ardhshem.

22.4 Administratoret leshojnë një "certifikate të aftësisë paguese", e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar përmbush kërkesat e pikës 22.3 me sipër. Nëse kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar nuk i përmbush kërkesat e pikës 22.3 me sipër, Administratoret nuk mund ta leshojnë certifikatën e aftësisë paguese.

22.5 Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise për vertetesinë e certifikates së aftësisë paguese.

KAPITULLI VIII

Ndryshimi i Formes Ligjore; Prishja

Neni 23. Ndryshimi i Formes Ligjore

23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund të ndryshojë me vendim të Asamblese së Pergjithshme sipas nenit 12 të percaktuara këtu dhe në perputhje me dispozitat respektive të Legjislacionit Shqiptar.

23.2 Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 24 Prishja e Shoqerise

24.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) Si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) Me hapjen e procedurave te likujdimit/falimentimit;
- (iv) Me vendim te Gjykates;
- (v) Per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

24.2 Administratoret duhet te regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me Nenin 43 te Ligjit nr. 9723, Per Qendren Kombetare te Regjistrimit. Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata duhet tia dergoje vendimin per regjistrim Qendres Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me Nenin 45 te Ligjit nr.9723, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

KAPITULLI IX Te Ndryshme

Neni 25. Te tjera


25.1 Te gjitha ceshtjet e tjera, te cila nuk jane permendur ne kete statut, do te rregullohen nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

* * * * *

Per Ortakun e Vetem:

(nenshkrimi)

Z. Alexandre Bouaziz

Perktheu
Sombu Sntara


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA SH. SELIMI



V2021052730303535721

DATE 14/06/2021
NR REP 4134



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 14/06/2021, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Sonila Shtaro, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036471466 e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë;” në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

VALBONA SH. SELIMI

